

VENDIM
Nr.927, datë 14.12.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.652, DATË 14.9.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”,
PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.652, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012, të jenë 7069. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”	6772
b) Kuotat e pranimeve për programe të dyta studimi	103
c) Kuotat për transferimin e studimeve	104
ç) Kuota për shtetas të huaj	50
d) Kuotat për personat që nuk shikojnë	20
dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët	20.”

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve të bukura” për kandidatët brenda territorit të vendit.	6437
b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve të bukura”, për aplikantët nga trojet jashtë kufijve të vendit.	335.”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Çdo program studimi i ciklit të dytë, “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, funksionon në vitin e parë për vitin akademik 2011-2012 në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë. Përjashtim nga ky rregull bëjnë programet e studimit të cilit të dytë “Master profesional”, të ofruara nga Universiteti i Arteve”.

4. Tabela nr.1, që i bashkëlidhej vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për

zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha